Dokumentacioni ndërtimor-Elaborati për Leje Mjedisore Komunale hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3)kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;
- Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

Leja Mjedisore Komunale – bazuar në nenin 9, pika 1 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 01/2017 për Dhënie të Lejes Mjedisore Komunale, përkatësisht shtojcës së këtij udhëzimi, aktiviteti i propozuar sipas projektit konceptual-kompleks me ndërtesa shumë banesore dhe afariste, i nënshtrohet procedurës për pajisje me Leje Mjedisore Komunale. Dokumentacioni ndërtimor-Elaborati për Leje Mjedisore Komunale, i hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3) kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;

Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

XII. Paguesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore - meqenëse parcelat kadastrale nr. 632-11, 633-0, 645-6, 645-7, 645-8, 645-9, 646-7, 646-8 dhe 646-9 ZK Matiçan, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, janë të evidentuara me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit “kullosë e klasës 4”, përkatësisht “arë e klasës 5”, kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Plani i situacionit -“zgjidhja urbane”-parcelës ndërtimore, dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, prej $S=500+340+79+400+400+114+250+368+269=2720.00$ m². Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrat kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,

Ky kompensim-pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

XIII. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të “Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01-0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkëinvestim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuarit/ve (bashkëpronarëve të parcelës-ave dhe investitorit).

XIV. Paguesa e taksës për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 Nr. 434/01-0094474/17 dt. 24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si pjesë përbërse e kërkesës për leje ndërtimore. Paguesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr. 06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

Paguesa e taksës administrative do të llogaritet edhe për rrënimin e ndërtimeve ekzistuese në kuadër të parcelës kadastrale, bazuar në gjendjen ekzistuese, incizimin gjeodezik dhe projektin ideor të atyre ndërtimeve, me pagesën e taksës së përcaktuar në pikën 5.9 të nenit 5 të rregullores së lartcekur dhe vendimit për lejimin e rrënit.

XV. Vlefshmëria e vendimit të kushteve ndërtimore është një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë së tyre.

Aplikuesit Erkand Sariqka dhe Zef Pervorfi nga Gjakova, me kërkesën 05 Nr. 350/02-0265331/18 dt. 05.11.2018, për rihapjen e procedurës administrative të përfunduar me Vendim 05 Nr. 350/02-0164799/18 dt. 20.07.2018, për refuzim të kërkesës për caktimin e kushteve ndërtimore (për “Grupi I-Faza 1”), dhe aplikuesit Hamit Olluri, Nexhmije Rexhepi, Sami Qyqalla dhe Shkodran Zhinipotoku nga Prishtina, dhe investitorit “Pozhegu Brothers” shpk, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 70518805, dhe me pronar Qemajl Pozhegu nga Prishtina, me kërkesën 05 Nr. 350/02-0297567/18 dt. 19.12.2018 (për “Grupi II-Faza 2”), kanë kërkuar nga kjo drejtori, hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore dhe afariste, në dy grupe/faza të ndara – Ndërtesa “A5/L1” (për “Grupi I-Faza 1”) dhe Ndërtesa “A5/L2” (për “Grupi II-Faza 2”), në kuadër të bllokut urban “A5”, të tërësisë “A”, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit të kushteve ndërtimore.

Me kërkesën 05 Nr. 350/02-0265331/18 dt. 05.11.2018, 05 Nr. 350/02-0164799/18 dt. 30.04.2018 dhe 05 Nr. 350/02-0297567/18 dt. 19.12.2018, kërkesave për plotësim të dokumentacionit, 05 Nr. 350/02-0265331/18/1 dt. 15.04.2019 dhe 05 Nr. 350/02-0297567/18/1 dt. 08.02.2019, si dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedimit administrativ, kërkuuesit kanë prezantuar dhe është trajtuar ky dokumentacion:

- Dëshmia mbi pronësinë për parcelën kadastrale nr. 646-7, 646-8 dhe 646-9 dhe certifikatën e njësisë kadastrale P-71914050-00646-7, P-71914050-00646-8 dhe P-71914050-00646-9 ZK Matiçan, lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës (kopje të vërtetuara nga origjinali, LRP Nr.: 9784/2018, dt. 28.09.2018, 9785/2018, dt. 28.09.2018, Nr. Rend.2424/2019 dt. 11.04.2019);
- Projekti konceptual - “zgjidhja urbane dhe projekti ideor”, hartuar nga “Arjak” shpk nga Gjakova;
- Shkresën “Informim nga Plani Rregullues “Mati I-PZHU”, me referencë 04-350/01-89411/18 dt. 26.04.2018, dhënë nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm e Komunës së Prishtinës;
- Manuali i incizimit gjeodezik, punuar nga gjeodeti i licencuar Fitore Lipovica, me licencë nr. 168;
- Vërtetimi mbi obligimet tatimore, në emër të Erkand Sariqka, nr. 83895/18 dt. 10.04.2018;
- Vërtetimi mbi obligimet tatimore, në emër të Erkand Sariqka, nr. 86300/18 dt. 15.04.2018;
- Vërtetimi mbi obligimet tatimore, në emër të Zef Pervorfi, nr. 83727/19 dt. 11.04.2018;
- Vërtetimi mbi obligimet tatimore, në emër të Zef Morina, sipas kërkesës së “Arjak” shpk, nr. 101878/18 dt. 30.04.2018;
- Aktin noterial “Autorizim”, dhënë nga bashkëpronarët e “Arjak” shpk, Zef Morina dhe Nikoll Morina nga Gjakova, për Dukagjin Morina nga Gjakova, i redaktuar te noteri Arbër Z. Sadiku në Gjakovë, LRP.nr.669/2016 dt. 22.01.2016 (kopje e pavërtetuar);
- Akti noterial “Para-kontratë për ndërrimin e paluajtshmërive”, e lidhur në mes të “Arjak” shpk nga Gjakova, si kontraktues, dhe Erkand Sariqka nga Gjakova, si blerës, vërtetuar te noteri Shaqir Vula në Gjakovë, LRP.nr. 1225/2018 Ref.nr: 275/2018 dt. 21.03.2018 (kopje e vërtetuar LRP.nr. 1225/2018 Ref.nr: 275/2018 dt. 21.03.2018);
- Aktin noterial “Autorizim”, dhënë nga Erkand Sariqka nga Gjakova për Blerim Sariqka nga Gjakova, i redaktuar në Zvicër, nr. 115, dt. 20.02.2018 (kopje e vërtetuar LRP.nr. 1225/2018 Ref.nr: 275/2018 dt. 21.03.2018);
- Aktin noterial “Autorizim”, dhënë nga Zef Pervorfi nga Gjakova për Dukagjin Morina nga Gjakova, i redaktuar te noteri Ramadan Bunjaku në Prishtinë, LRP.Nr.rend.2408/2019, dt. 11.04.2019;
- Akti noterial “Para-kontratë për shit-blerjen e paluajtshmërisë”, e lidhur në mes të Pjeter Nikolla nga Gjakova, si shitës dhe “Arjak” shpk nga Gjakova, si blerës, vërtetuar te noteri Shaqir Vula në Gjakovë, LRP.nr. 604/2018 Ref.nr: 125/2018 dt. 07.02.2018 (kopje e vërtetuar LRP.nr. 1225/2018 Ref.nr: 275/2018 dt. 21.03.2018);
- Shkresën “Deklaratë” e dhënë nga Zef dhe Vjollca Pervorfi nga Gjakova, për pëlqim me zgjidhjen urbane, të punuar nga kompania “Arjak” nga Gjakova, e vërtetuar te noteri Ramadan Bunjaku në Prishtinë-vërtetimi i nënshkrimit Nr. rend. 6502/2018, dt. 09.08.2018 dhe vërtetim të kopjes nga origjinali, Nr. rend. 6503/2018 dt. 09.08.2018;

- Dëshmia mbi pronësinë për parcelën kadastrale nr. 645-6, 645-7, 645-8, 645-9, 645-10, 646-10 dhe 632-11 dhe certifikatën e njësisë kadastrale P-71914050-00645-6, P-71914050-00645-7, P-71914050-00645-8, P-71914050-00645-9, P-71914050-00645-10, P-71914050-00646-10 dhe P-71914050-00632-11 ZK Matiçan, lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës (kopje të vërtetuara nga origjinali LRP. nr. 11892/2018, dt. 01.11.2018, LRP.Nr.6961/19 dt. 02.05.2019);
- Aktin noterial “Autorizim i përgjithshëm”, dhënë nga kompania “Pozhegu Brothers” shpk-pronari Qemajl Pozhegu nga Prishtina për Gëzim Dedinca nga Prishtina, i përpiluar dhe redaktuar te noteri Sefadin Blakaj në Prishtinë, me LRP.nr.: 11308/2017, dt. 01.11.2017 (kopje e vërtetuar nga origjinali);
- Vërtetimi mbi obligimet tatimore, në emër të Qemajl Pozhegu, në bazë të kërkesës së “Pozhegu Brothers” shpk, nr. 292257/18 dt. 12.12.2018;
- Vërtetimi mbi obligimet tatimore, në emër të Sami Qyqalla, nr. 292604/18 dt. 12.12.2018;
- Vërtetimi mbi obligimet tatimore, në emër të Nexhmije Rexhepi, nr. 83895/18 dt. 10.04.2018;
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit të “Pozhegu Brothers” shpk, nr. 70518805;
- Aktin noterial “Kontratë për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore”, e lidhur në mes të pronarit Sami Qyqalla nga Prishtina, dhe investitorit “Pozhegu Brothers” shpk, me seli në Prishtinë, me pronar Qemajl Pozhegu nga Prishtina, redaktuar dhe vërtetuar te noteri Sefadin Blakaj në Prishtinë, (akt en minute) Nr. i LRP: 11534/2018, Nr. i Ref.: 2340/2018 dt. 17.10.2018 (kopje e vërtetuar nga origjinali);
- Aktin noterial “Para-Kontratë për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore”, e lidhur në mes të pronarit Shkodran Zhinipotoku nga Prishtina, dhe investitorit “Pozhegu Brothers” shpk, me seli në Prishtinë, me pronar Qemajl Pozhegu nga Prishtina, redaktuar dhe vërtetuar te noteri Sefadin Blakaj në Prishtinë, (akt en minute) Nr. i LRP: 732/2019, Nr. i Ref.: 168/2019 dt. 21.01.2019 (kopje e vërtetuar nga origjinali);
- Aktin noterial “Kontratë për ndërtimin e përbashkët, rregullimin e raporteve pronësore dhe kalimin e kushtëzuar të pronësisë së palujtshmërisë në investitorin”, e lidhur në mes të pronarit Hamit Olluri nga Lipjani, dhe investitorit “Pozhegu Brothers” shpk, me seli në Prishtinë, me pronar Qemajl Pozhegu nga Prishtina, redaktuar dhe vërtetuar te noteri Sefadin Blakaj në Prishtinë, (akt en minute) Nr. i LRP: 1775/2019, Nr. i Ref.: 332/2019 dt. 20.02.2019 (kopje e vërtetuar nga origjinali);
- Aktin noterial “Kontratë për shit-blerjen e patundshmërisë, e lidhur nën kushtin shtytës”, e lidhur në mes të pronares-shitëses Nexhmije nga Prishtina, dhe investitorit-blerësit “Pozhegu Brothers” shpk, me seli në Prishtinë, me pronar Qemajl Pozhegu nga Prishtina, vërtetuar te noteri Sefadin Blakaj në Prishtinë, (akt en minute) Nr. i LRP: 11892/2018, Nr. i Ref.: 2453/2018 dt. 01.11.2018 (kopje e vërtetuar nga origjinali);
- Shkresën “Informim nga Plani Rregullues Mati I-PZHU”, me referencë 1942;1943 dt. 05.11.2018, të dates 07.11.2018, dhënë nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm e Komunës së Prishtinës, përmes sistemit online;
- Manuali i incizimit gjeodezik, punuar nga kompania gjeodetet e licencuar “Geo Limit” shpk, nga Prishtina, me licencë nr. 50;
- Projekti konceptual - “zgjidhja urbane”, hartuar nga kompania “Pozhegu Brothers” shpk nga Prishtina;
- Shkresën “Informim nga Plani Rregullues “Mati I-PZHU”, me referencë 04-350/01-89411/18 dt. 26.04.2018, dhënë nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm e Komunës së Prishtinës;
- Fotokopja e letërnjoftimit të pronarëve, të autorizuarve dhe të pronarëve të “Arjak” shpk;
- Fotot e lokacionit.

Drejtorja e Urbanizmit, pas pranimit të kërkesave të ndara 05 Nr. 350/02-0265331/18 dt. 05.11.2018, 05 Nr. 350/02-0164799/18 dt. 30.04.2018 dhe 05 Nr. 350/02-0297567/18 dt. 19.12.2018, dhe plotësuar me shkresat “Plotësim dokumentacioni” 05 Nr. 350/02-0265331/18/1 dt. 15.04.2019 dhe 05 Nr. 350/02-0297567/18/1 dt. 08.02.2019, shqyrtimit të përmbajtjes së tyre dhe lokacionit, për të cilën kërkohet përcaktimi i kushteve ndërtimore, duke u mbështet në paragrafin 1. nenin 84 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku thuhet se, citojmë: “*Organi publik*”

kompetent mund të bashkoj disa procedura administrative në një të vetme nëse të drejtat dhe detyrimet e palëve të përfshira bazohen në një gjendje faktike dhe bazë juridike të njëjtë apo të ngjajshme”, vendosi ti bashkojë dhe trajtojë në një procedurë të vetme administrative, gjegjësisht ti trajtojë me një vendim të kushteve ndërtimore, duke u bazuar edhe në faktin se parcelat kadastrale të lartcekura dhe të trajtuara, përfshihen në kuadër të të njëjtit blloku urban “A5”, të tërësisë ”A” të Planit Rregullues “Mati I” në Prishtinë.

Pas këtij konstatimi dhe veprimi administrativ, kjo drejtori mori në shqyrtim kërkesat e lartcekura, dokumentacionet e bashkëngjitura, konsultoi dokumentet e planifikimit hapësinor për lokacionin ku shtrihen parcelat - Pani Rregullues “Mati I” dhe Planin Zhvillimor Urban, rregullativën ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, projekt propozimet-projektet konceptuale me “zgjidhja urbane” dhe projektet ideore, dhe procedurat e zhvilluara gjatë fazës së procedimit administrativ, në mënyrë procedurale dhe në mënyrë kronologjike konstatoi se:

Me Vendimin 05 Nr. 350/02-0101951/18 dt. 19.06.2018, kjo drejtori ka refuzuar kërkesën 05 Nr. 350/02-0101951/18 dt. 10.07.2018, në emër të Erkand Sariqka nga Gjakova, për caktim të kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor-projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesë shumëbanesore dhe afariste, në kuadër të bllokut urban “A5”, të Planit Rregullues “Mati I” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 646-7 dhe 646-8 ZK Matiçan, duke u bazuar në nenin 21 pika 4 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, pasi që aplikuesi nuk i është përmbajtur afatit ligjor të caktuar për plotësim të dokumentacionit të kërkuar;

Me Vendim 05 Nr. 350/02-0164799/18 dt. 20.07.2018, është refuzuar kërkesa për rihapjen e procedurës administrative për kundërshtim të Vendimit për refuzim të kërkesës 05 Nr. 350/02-0101951/18 dt. 19.06.2018, konform nenit 140 dhe 142 të Ligjit Nr. 05/L-03 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pas konstatimit se aplikuesi nuk ka siguruar prova të reja për të vendosur ndryshe.

Me kërkesën 05 Nr. 350/02-0265331/18 dt. 05.11.2018, aplikuesit Erkand Sariqka dhe Zef Përvorfi nga Gjakova, kanë kërkuar rihapjen e procedurës administrative, të përfunduar me Vendim 05 Nr. 350/02-0164799/18 dt. 20.07.2018, duke përfshirë në trajtim edhe parcelën kadastrale nr. 646-9 ZK Matiçan, në emër të Zef Përvorfi, dhe duke prezantuar projektin konceptual-“zgjidhjen urbane”, me propozim të kushteve ndërtimore për parcelat kadastrale nr. 646-7, 646-8 dhe 646-9 ZK Matiçan. Sipas analizës urb-arkitektonike të projektit konceptual, të prezantuar për pjesën e bllokut urban “A5” dhe të planit rregullues, është konstatuar se parcelat kadastrale nr. 645-7, 645-8, 645-9, 645-10 (rrugë ekzistuese) dhe 646-10 (rrugë ekzistuese), 632-11, 632-16, 632-15 ZK Matiçan, të cilat shtrihen në kuadër të kësaj pjese të bllokut urban “A5”, duhet të përfshihen në trajtim, me qëllim të sigurimit të një zgjidhjeje urbane më funksionale dhe mundësimi të zhvillimit edhe të këtyre parcelave.

Në ndërkohë, në këtë drejtori, është pranuar kërkesa 05 Nr. 350/02-0297567/18 dt. 19.12.2018, në emër të Nexhmije Rexhepi dhe Sami Qyqalla, dhe investitorit “Pozhegu Brothers” shpk me seli në Prishtinë, për caktim të kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor-projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesë shumëbanesore dhe afariste, në kuadër të bllokut urban “A5”, të Planit Rregullues “Mati I” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 645-6, 645-7, 645-8, 645-9 dhe 645-10 ZK Matiçan.

Duke u bazuar në nenin 18 të Ligji Nr.04/L-110 për Ndërtim, pikën 1.2 dhe 1.2.2 të nenit 13 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, kjo drejtori me datë 16.11.2018, përkatësisht 22.01.2019, ka vendosur njoftimin publik në hapësira të dukshme dhe frekuentuese të lokacionit dhe rrethinës në diametër prej 50 m`, për të njoftuar publikun me synimin e pronarëve dhe investitorit, për ndërtim, dhe i njëjti është lënë në dispozicion të tyre për 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, për t`ju mundësuar të interesuarve paraqitjen e vërejtjeve dhe komenteve. Ky njoftim publik ka vazhduar të qëndrojë deri me datën 30.11.2018, përkatësisht 05.2.2019, dhe gjatë kësaj periudhe kohore, në postën elektronike zyrtare nuk ka arritur asnjë ankesë, kërkesë, vërejtje apo sugjerim nga qytetarët e asaj zone.

Pas vendimit të kësaj drejtorie, për trajtim në një procedurë të vetme administrative të të dy kërkesave të lartshënuara, dhe pas konstatimit se parcelat kadastrale nr. 632-11, 632-15 dhe 632-16 ZK Matiçan, kanë mbetë pa u përfshirë në trajtim, përmes ftesave zyrtare të datës 16.01.2019, janë

ftuar pronarët e parcelave të referuara, që me datë 23.01.2019, të marrin pjesë në takim për t'u informuar dhe deklaruar lidhur me projektin konceptual-“zgjidhjen urbane” të propozuar, dhe përfshirjen eventuale të tyre në këtë zgjidhje. Në takimin e mbajtur, palët prezentë u deklaruan se do të vazhdojnë negociatat për hartim-përfshirje në këtë zgjidhje urbane dhe më pas të vendosin lidhur me këtë çështje.

Bazuar në aktet noteriale “Kontratë për ndërtimin e përbashkët, rregullimin e raporteve pronësore dhe kalimin e kushtëzuar të pronësisë së palujtshme në investitorin”, Nr. i LRP: 1775/2019, Nr. i Ref.: 332/2019 dt. 20.02.2019, dhe “Para-Kontratë për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore”, Nr. i LRP: 732/2019, Nr. i Ref.: 168/2019 dt. 21.01.2019, pronari i parcelës kadastrale nr. 632-11 dhe 646-10 ZK Matiçan, kanë arrit marrëveshje me investitorin “Pozhegu Brothers” shpk, për përfshirje në ndërtim, ndërsa pronarët e parcelave kadastrale nr. 632-15 dhe 632-16 ZK Matiçan, edhe njëherë janë ftuar në këtë drejtori, dhe përfaqësuesit e tyre kanë deklaruar se nuk janë të pajtimit të përfshihen në trajtim në këtë zgjidhje urbane, me arsyetimin se koeficienti i ndërtimit për këtë zonë, është shumë i ulët.

Bazuar në projektin konceptual-plani i situacionit-“zgjidhja urbane” të prezantuar, kompleksi i pjesëve dhe parcelave kadastrale nr. 645-6, 645-7, 645-8, 645-9, 645-10, 646-7, 646-8, 646-9, 646-10, 632-11 dhe 633-0 ZK Matiçan, përfshihet në kuadër të pjesës së bllokut urban “A5” dhe pjesërisht, pjesë të disa parcelave kadastrale, shtrihen në hapësira publike të planifikuara –rrugë dhe gjelbërim të planifikuar, dhe ku sipas këtij plani, destinimi i hapësirës është “zonë kryesisht me banim-RM”, gjegjësisht ndërtesa shumë banesore dhe afariste, i cili destinim është i propozuar edhe nga aplikuesit. Zgjidhja urbane është konceptuar në dy parcela ndërtimore, dy grupe dhe dy faza të realizimit, konkretisht sipas përshkrimeve të prezantuara në pikat a) dhe b) të paragrafit IV. të dispozitivit të vendimit të kushteve ndërtimore, në kuadër të “Grupi I” – “Faza 1” janë përfshi parcelat kadastrale, nr. 645-6, 645-7 dhe 645-8 ZK Matiçan, kurse në kuadër të “Grupi II” – “Faza 2” janë trajtuar parcela kadastrale nr. 645-9, 645-10, 646-7, 646-8, 646-9, 646-10, 632-11 dhe 633-0 ZK Matiçan.

Sipas projektit konceptual dhe planit rregullues, jashtë vijës rregulluese të bllokut urban “A5” shtrihen pjesët e parcelës kadastrale nr. 645-6, 645-10, 646-7, 646-10 ZK Matiçan, me sipërfaqe të përgjithshme $S=543 \text{ m}^2$, në pronësi private, në sipërfaqe të planifikuar për interes publik, përkatësisht në rrugë dhe gjelbërim të planifikuar. Me aplikimin e Vendimit 01 Nr. 400-660 dt.26.05.2008 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për kompensimin e pronës private, të planifikuar për interes publik, me koeficient të ndërtimit, është propozuar që sipërfaqja e parcelës ndërtimore (brenda vijës rregulluese) të shtohet deri në 20 % të sipërfaqes së përgjithshme të parcelës ndërtimore, përkatësisht përcaktuar në përqindje (%), është $S=543/3044 \times 100=17.84 \%$. Dhe, sipas kalkulimit me koeficient ndërtimi sipërfaqja e kompensuar do të jetë, $S=543 \times 1.2=651.60 \text{ m}^2$. Kompensimi i pronës private do të realizohet sipas mënyrës dhe procedurës së përshkruar në pikën VI të këtij vendimi, në Drejtorinë e Pronës të Komunës së Prishtinës.

Pas përfundimit të procedurës për kompensimin me koeficient ndërtimi të pronës private, duhet të përfundohet edhe procedura e ndarjes dhe bashkimit të parcelave të trajtuara, në një parcelë të vetme ndërtimore, sipas përshkrimit në pikën VII dhe VIII të këtij vendimi, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës.

Brenda vijës rregulluese të bllokut urban, në pjesën jugore të parcelës ndërtimore, shtrihet pjesa e parcelës kadastrale nr. 633-0 ZK Matiçan, me sipërfaqe $S=340 \text{ m}^2$, në pronësi/posedim të P.SH. Rrugët KK Prishtinë, e cila, nga pronarët dhe investitori, është propozuar të këmbehet me pjesën e parcelës kadastrale nr. 645-9, me pronare Nexhmije Rexhepi, me sipërfaqe $S=335 \text{ m}^2$, dhe pjesën e parcelës kadastrale 645-10 ZK Matiçan, me pronar Sami Qyqalla, me sipërfaqe $S=5 \text{ m}^2$, me sipërfaqe të përgjithshme $S=335+5=340 \text{ m}^2$, bazuar në Ligjin Nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujtshme të Komunës. Procedura e këmbimit duhet të realizohet, në Drejtorinë e Pronës të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore, me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, dhe mos zbatimi i kësaj procedure, për arsye të ndryshme, detyron Drejtorinë e Urbanizmit, të rishikojë kushtet ndërtimore - revokimin e tyre.

Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit – ekspertit për komunikacion, janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren, për kyçje të kompleksit në rrugën e planifikuar të planit rregullues, si dhe organizimin e vendparkimeve, në kuadër të atij kompleksi, dhe është konstatuar, si në vijim:

“Pas shiqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane lidhur me kërkesën për kushte ndërtimore të Pozhegu Brothers, me kërkesën nr. 05-350/02-0297567 dt. 19.12.2018 dhe Erkon Soriqka me kërkesën 05-350/02-0265331/18 dt. 05.11.2018, në lagjen Mati 1, Prishtinë, kyçja për automjete në rrugë të planifikuar përmes kësaj zgjidhje për ndërtesën A5/L1 me etazhitet B+P+3+PH, dhe ndërtesën A5/L2 me etazhitet B+P+6, në lagjen Mati 1, në Prishtinë, mund të pranohet si e till, duke marr parasysh rrugët e brendshme të zgjidhjes dhe lidhjet e tyre me rrugën e planifikuar. Në fazat e ardhshme të projektimit dhe realizimit të ndërtesave banesore me afarizëm për rampa dhe vend parkime, duhet të aplikohen kriteret sipas “Rregullores për Normat Teknike për Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi”, dhe të arrihen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjes. Gjerësia e rrugëve kaluese me qarkullim dy kahor përgjatë hapësirave të vend parkimeve të jashtme dhe të brendshme në garazha, duhet të jetë minimum 5.5m. Ndryshime në rrugë të planifikuar sa i përket regjimit të trafikut me qëllim të favorizimit të ndërtesave banimore afariste nuk duhet të ketë. Kyçja duhet të harmonizohet dhe të përshtatet me profilin e rrugës së planifikuar edhe në kohën kur realizohet ajo”.

Bazuar në konstatimet e më sipërme dhe dokumentacionin e shqyrtuar, rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenin 21 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor dhe nenin 13 të “Udhëzim Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve”, Drejtoria e Urbanizmit ka konstatuar se kërkuesit kanë prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, se plani i situacionit-“zgjidhja urbane”, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të planit rregullues urban për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Dispozita urbanistike -”zgjidhja urbane” me ndërtesa të planifikuara, Situacioni i parcelave kadastrale me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga Plani Rregullues në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe manuali i ndarjes dhe bashkimit të parcelave kadastrale nr. 632-11, 645-6, 645-7, 645-8, 645-9, 645-10, 646-7, 646-8, 646-9, 646-10 dhe 633-0 ZK Matëan.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH.

Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Aplikuesve/Investitorit (të të dy kërkesave), Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës 05 Nr. 350/02-0265331/18 dt. 05.11.2018 dhe 05 Nr. 350/02-0297567/18 dt.19.12.2018

Kopja elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Pronës, Drejtorisë së Kadastrit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 Nr. 350/02-0265331/18 dhe 05 Nr. 350/02-0297567/18 DT. 12.06.2019

Zyrtari,
Nazife Krasniqi

U.D. Udhëheqëse e sektorit,
Mimoza Berisha Prestreshi

